

VENDIM
Nr. 280, datë 9.5.2019

PËR SHPALLJE DITË ZIE KOMBËTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 4, të nenit 4, të ligjit nr. 8926, datë 22.7.2002, “Për formën dhe përmasat e flamurit kombëtar, përmbajtjen e himnit kombëtar, formën dhe përmasat e stemës së Republikës së Shqipërisë dhe mënyrën e përdorimit të tyre”, të pikave 2 e 3, të nenit 45, të ligjit nr.9210, datë 23.3.2004, “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe në vijim të pikës 12, të kapitullit VI, të Ceremonialit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë, bashkëlidhur vendimit nr. 420, datë 8.6.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen ditë zie kombëtare, ditën e premte, datë 10.5.2019, në nderim të nëntetar Zarife Muharrem Hasanaj, rënë në krye të detyrës gjatë përmbushjes së misionit ushtarak jashtë vendit.
2. Në të gjitha institucionet shtetërore e publike të ulet flamuri kombëtar në gjysmështizë dhe në orën 12:00 të mbahet një minutë heshtje.
3. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të ndjekë organizimin e ceremonialit dhe të përballojë shpenzimet e varrimit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama